

VENDIM
Nr. 79, datë 13.4.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “M.C INERTE LUMZI” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”; dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/12 prot., datë 8.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 28.2.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 70/5 prot., datë 1.2.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 15.3.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k. rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin për aplikim, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b” “c” dhe “d”: plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” “c” dhe “d”: plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli